

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –II-
**KOMISIONI PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR**

Procesverbal **Nr. 79**
nga mbledhja publike e mbajtur më **4.9.2007**
kryesuar nga **Rifat Krasniç**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 11,00

Të pranishëm :

1. Rifat **KRASNIÇ** kryetar
2. Jusuf **SUTAJ**
3. Shaban **HALIMI**
4. Zyhrrie **MALOKU**
5. Berat **LUZHA**
6. Sadudin **BERISHA**
7. Afrim **ARZUALLXHIU**
8. XHelal **CANZIBA**
9. Fetah **BERISHA**

Munguan :

10. Lulzim **ZENELI** nënkryetar-I
11. Gazmend **MUHAXHERI**
12. Selvije **HALIMI**
13. Goran **BOGDANOVIĆ**-nënkryetar-II-
- 14.

TË FTUARIT : nga MMPH dhe MBPZHR

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i projektligjit për Parqet Nacionale
3. Të ndryshme

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi hapi mbledhjen dhe konstatoi se lidhur me pikën 1 nuk ka vërejtje.

Shqyrtimi i Projektligjit për Parqet Nacionale

Kryetari në fillim përshëndeti anëtarët e komisionit dhe konstatoi se në këtë mbledhje komisioni duhet të përfundojë shqyrtimin e projektligjit për parqet nacionale ashtu si ka vendosur në mbledhjen e dt.17.7.2007, prandaj para se të shqyrtohen nenet e këtij projekti, kërkoi mendimin e anëtarëve të komisionit.

Berat Luzha shprehi dyshimin se komisioni mund të bëjë punën ashtu si duhet, ngase si theksoi ai asnjë ndryshim esencial nuk ka nga ana e MMPH, përkundrazi 4 vite ky projekt kthehet në Qeveri (MMPH) por asgjë nuk përmirësohet.

Jusuf Sutaj ishte i mendimit se dy ministrat nuk i kanë kryer obligimet si duhet edhe pse kemi qëndrimin nga Qeveria se ajo pajtohet me nenin 6 të mos ndryshohet, ndaj propozoi që përfaqësuesit e ministrave të largohen nga mbledhja dhe komisioni të vazhdojë punën. Edhe **Zyhrrie Maloku** konstatoi se nuk ka ndonjë ndryshim dhe ishte në dilemë çka të propozoi për vazhdimin e punës së mëtejme të komisionit.

Përfaqësuesit e dy ministrave (Muzafer Luma dhe Nazmi Shkodra) mbetën pranë deklaratave të mëhershme se sipërfaqja dhe menaxhimi duhet të qartësohen, përkatësisht se parku duhet të shpallet ashtu si është propozuar në këtë projektligj. Nazmi Shkodra shtoi se zvogëlimi i sipërfaqes mund të bëhet në teren, ndërsa menaxhimi i pyjeve i mbetet APK-së. Berat Luzha reagoi negativisht dhe konstatoi se zvogëlimi i sipërfaqes bëhet vetëm me ligj. Muzafer Luma poashtu shtoi se ky komision ka mundur të bindet kur ishte në vizitë tek malet e Sharrit sa janë në gjendje të mjerueshme (dëmtuara) malet në përgjithësi për shkak të kompetencave të dyfishta nga këto dy ministri (MBPZHR dhe MMPH).

Sadudin Berisha shprehu zhgënjimin me gjendjen e krijuar për shkak se dy ministrat nuk mundën të mirën vesh, përkundër qëndrimit të Qeverisë se pajtohet me nenin 6 të projektligjit (të cilin e citoi fjalë për fjalë). Ai ju rikujtoi të pranishmëve se ky komision duhet të ketë parasysh llogaridhënien dhe të veprimet më tutje duke dërguar projektligjin seancës plenare.

Berat Luzha tha se “llogaridhënia i takon Qeverisë sepse me kryeneçësi na dërgon projektin pa ndryshuar fare që 4 vite” dhe shtoi se nga 4 komunat, tri komuna nuk pajtohen me sipërfaqen si është në projekt, e kundërshtoi Nazmi Shkodra të cilin z. Luzha e pyeti “sa ka dorë MMPH në malet e Sharrit” (duke aluduar se aspak nuk ka).

Sadudin Berisha konstatoi lodhjen dhe maltretimin e komisionit me këto ngarkesa nga dy ministrat.

Rifat Krasniç – kryetar i luti përfaqësuesit e ministrave të lëshojnë mbledhjen, ndërsa komisioni vazhdoi punën. Në vazhdim pyeti anëtarët e komisionit si të vazhdohet puna. Shumica e anëtarëve të komisionit konstatuan se dëshira për vazhdimin e punës ekziston por mundësit janë të zbehta ngase mosndryshimi i

projektit me vërejtjet përkatëse të këtij komisioni e bëjnë të pamundur përfundimin e tij me sukses ashtu si duhet .

Përgjegjësia politike ekziston dhe është e gatshme por përgjegjësia profesionale nuk lejon që ky komision të përfundojë punën, për shkak të angazhimeve jo të mjaftueshme të Qeverisë në këtë drejtim, përfundoi **Sadudin Berisha**.

Berat Luzha në fund theksoi se nuk dëshiron një ligj i cili 10% të Kosovës e shpallë park përkatësisht ¼ e pyjeve të Kosovës i shndërron në parqe.

Rifat Krasniç propozoi që edhe një herë komisioni të mblidhet.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Deri sot një javë , kur do të mbahet mbledhja e komisionit, të shqyrtohen mundësit e vendimit të komisionit lidhur me projektligjin për parqet nacionale, ngase në atë mbledhje duhet ti rekomandohet seancës plenare lidhur me projektligjin në fjalë.

Të ndryshme

Në këtë pikë kryetari kërkoi nga anëtarët e komisionit të propozojnë delegacionet për tri vizita në vendet e rajonit sipas formulës 5+1, ndërsa komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Caktohen delegacionet si vijon :

Në Maqedoni :

1. Rifat Krasniç-kryetar i komisionit –Partia turke
2. Lulzim Zeneli-nënkryetar i komisioni-LDD
3. Shaban Halimi-LDK
4. Gazmend Muhaxheri-ORA
5. Xhelal Canziba-PDK

1. Koordinator i Komisionit Bajram Badivuku

Në Slloveni :

1. Rifat Krasniç-kryetar Partia Turke
2. Jusuf Sutaj-LDK
3. Sadudin Berisha-LDK
4. Berat Luzha-PDK
5. Zyhrie Maloku-LDK

1. Koordinator Komisionit Bajram Badivuku

Në Malin e Zi

- 1.Rifat Krasniç-kryetar
2. Fetah Berisha-LDK
3. Selviqe Halimi PDK
4. Xhelal Canziba PDK
5. Sadudin Berisha LDK

1. Koordinator i Komisionit-Bajram Badivuku

Fillimisht komisioni duhet të bëjë shkresat këtyre shteteve rreth vizitave, ndërsa stafi i komisionit ti bëjë përgatitjet tjera në bashkëpunim me përfaqësuesin e OSBE z. **Blerim Vela**.

Kryetari caktoi mbledhjen e radhës me pikën e sotme të rendit të ditës dhe me projektligjin për shitjen e banesave.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryetari i Komisionit,
Rifat Krasniç

